



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Më 21. 08. 2019

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Vushtrrisë, shpall konkurs letrar të poezisë për Festivalin:

“TAKIMET E POETESHAVE SHQIPTARE 2019”

Këtë vit, në Vushtrri, do të mbahet Edicioni 37 i Festivalit “ **Takimet e Poeteshave Shqiptare 2019**”, në të cilën inkurajohen, që me poezitë e tyre të konkurrojnë të gjitha krijueset shqiptare nga të gjitha trojet shqiptare, përfshirë edhe poetet nga mërgata.

Qëllimi i konkursit

- Ruajtja, kultivimi dhe zhvillimi i kulturës tek femrat shqiptare;
- Nxitja, motivimi dhe promovimi i krijueseve shqiptare.

Kushtet për pjesëmarrje

- Poetet konkurrojnë me emër dhe mbiemër dhe të jenë të moshës mbi 18 vjeçe.
- Poetet konkurrojnë vetëm me nga një poezi,
- Format i shkronjave duhet të jetë: Mikrosoft Word, Time New Roman, 12,
- Poezitë duhet të jenë në gjuhën shqipe, të pabotuara më parë;
- Poezitë të dërgohen përmes postës elektronike në adresën festivali.poeteshav@gmail.com (Secilës poete i konfirmohet pranimi i poezisë përmes postës elektronike).
- Poetet, së bashku me punimet e tyre dërgojnë: dy numra kontakti (të qasshëm në çdo kohë), një biografi të shkurtër të krijimtarisë së poetes dhe njëfotoportret.
- 21 poeteshat që do të përzgjidhen për të vazhduar në fazën e dytë të konkurrimit do të njoftohen me kohë për detajet tjera në lidhje me organizimin e Festivalit.

Afati i dërgimit

- Afati i dërgimit të poezive është i hapur **15 ditë**, nga dita e shpalljes.

Poezitë e arritura do të grumbullohen në dosje, pa të dhëna të autorësisë dhe vetëm me shifër, të cilën secilës poezi ia vendosë zyrtari i DKRS-së. Poezitë do të vlerësohen nga juria profesionale, e cila do të bëjë leximin dhe vlerësimin e poezive, pa pasur dijeni mbi autoren, por vetëm në bazë të shifrës, të cilën ia vendosë zyrtari i DKRS-së. Juria do të përmbyllë procesin e vlerësimit para datës së mbajtjes së festivalit, ndërsa ndarja e çmimeve do të bëhet në ditën e mbajtjes së festivalit. Për pjesëmarrje në festival do të kontaktohen vetëm poetet, poezitë e të cilave janë përzgjedhur për të vazhduar konkurrimin.

Poetet që do të vazhdojnë konkurrimin do të njoftohen përmes telefonit më së largu deri më datë: **13.09.2019**, ndërsa ato poete që nuk ftohen deri në këtë datë do të thotë që poezitë e tyre nuk janë përzgjedhur nga juria për të vazhduar më tutje.

Në këtë festival dyditorë të poezisë do të ndahen këto çmime për poezi:

Çmimi i parë.....	500 €
Çmimi i dytë	300 €
Çmimi i tretë	200€
Debutuesja (poetja më e re në moshë).....	100 €

Për të gjitha poetet, poezitë e të cilave do të përzgjidhen nga juria, për pjesëmarrje në festival, organizatori mbulon shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit.

Për informata më të hollësishme mund të shkruani në e-mail adresën e lartshënuar dhe të lidheni në web-faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë: <http://kk.rks-gov.net/vushtri>